

TERMA REFERENCE

EKSPERT - FOLËS (SPEAKER) NË OPEN FORUME ME QËLLIM NDËRGJEGJËSIMIN E TË RINJVE MBI INTEGRITETIN E ZGJEDHJEVE DHE PROCESIN E DEKRIMINALIZIMIT NË RAJONET KUKËS DHE LEZHË

Pozicioni / Shërbim	Folës (Speaker) në open forume me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve mbi integritetin e zgjedhjeve dhe procesin e dekriminalizimit në rajonet Kukës dhe Lezhë.
Titulli i Projektit	“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”
Mbështetur:	Projekti financohet nga Ambasada Britanike në Shqipëri
Lloji i Kontratës :	Kontratë shërbimi: Eksperti (speaker) njohës i problematikave në nivel kombëtar për open forume në Kukës dhe Lezhë Kontratë shërbimi: Ekspert folës (Speaker) njohës i problematikave në nivel lokal për open forume në Kukës dhe Lezhë
Periudha e kontratës	Shkurt 2024
Ditë pune	në nivel kombëtar: 2 ditë pune në nivel lokal: 1 ditë pune

Informacion i përgjithshëm për Projektin

- Projekti ka për qëllim të kontribuojë në parandalimin dhe shfaqjen e ndikimeve të panevojshme përmes angazhimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin, si dhe përmes informimit të një grupi të rëndësishëm të aktorëve dhe palëve të interesuara për të siguruar implementimin e drejtë dhe të lirë nga ndikimet e panevojshme në procesin zgjedhor.
- Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

Qëllimi i shërbimit

Në kuadër të implementimit të projektit “*Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike*”, Instituti i Studimeve Politike kërkon ekspert - folës (speaker) njohës i problematikave në nivel kombëtar dhe nivel lokal për open forume në Kukës dhe Lezhë me qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve mbi integritetin e zgjedhjeve dhe procesin e dekriminalizimit.

Eksperti (speaker) për problematikat në nivel kombëtar do të jetë përgjegjës për:

- Identifikim e praktikave/ aktiviteteve politike apo partiake në nivel kombëtar të cilat kanë nevojë të përmirësohen në mënyrë që ti shërbejnë fuqizimit të integritetit të zgjedhjeve dhe qëndrueshmërisë të partive;
- Sjelljen e rasteve dhe shembujve në nivel kombëtar të qeverisjes të mirë në shërbim të projektit dhe aktivitetit për në fjalë;
- Diskutim me audiencën në lidhje me shembujt e prezantuar;

Eksperti (speaker) për problematikat në nivel lokal do të jetë përgjegjës për:

- Identifikim e praktikave/ aktiviteteve politike apo partiake në nivel lokal të cilat kanë nevojë të përmirësohen në mënyrë që ti shërbejnë fuqizimit të integritetit të zgjedhjeve dhe qëndrueshmërisë të partive;
- Krahasimin e rasteve dhe shembujve të qeverisjes të mirë të nivelit lokal në raport me rastet dhe shembujt (në nivel kombëtar) të sjellë për diskutim;
- Identifikimin e rasteve lokale në lidhje me vendimet e marra nga SPAK;
- Përfshirjen e audiencës në diskutime për temën e caktuar;

Gjithashtu Ekspertët duhen:

- Të mundësojë dorëzimin e timesheet-eve, duke raportuar mbi orët e shërbimit të realizuara në përputhje me qëllimin e shërbimit të kërkuar, apo çdo dokument shoqërues që do të duhet për raportimin e shërbimit;
- Të jetë disponibël për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e kërkuar sipas afatit kohor të përcaktuar;
- Të mbrojë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të shërbimit.

Profili i ekspertit:

- Diplomuar në nivelin Master Profesional/Shkencor për Shkenca Politike, Juridike, Sociale apo Shkenca Komunikimi;
- Eksperienca të mëparshme bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- Njohës i legjislacionit zgjedhor dhe i ligjit të dekriminalizimit.

Aftësitë individuale:

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip dhe jo vetëm;
4. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afatet e vendosura.

Dokumentet e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për pozicionin e ekspertit duhet të dorëzojnë:

1. CV e detajuar
2. Ofertë Financiare e nënshkruar në GBP

Kostot dhe Pagesat

Kosto totale për sigurimin e këtij shërbimi për gjithë periudhën parashikohet të jetë 200 GBP (dyqind) bruto. Mënyra e pagesës përcaktohet në Kontratën e Shërbimit pas punës së kryer.

Aplikimi duhet të dërgohen në një nga 3 variantet, për open forume në Kukës jo më vonë se data 07/02/2024 ora 16:00 dhe për open forume në Lezhë jo më vonë se data 12/02/2024 ora 16:00

1. **Në formë elektronike** në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com,
2. **Me postë** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*ISP_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike – ekspert qendor dhe lokal –folës (Speaker) në open forume Kukës dhe Lezhë. Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë
3. **Dorazi** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*ISP_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike - ekspert qendor dhe lokal - folës(Speaker) në open forume Kukës dhe Lezhë. Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

(Lutemi specifikoni qartë e-mail ose një nr. kontakti.)

Instituti i Studimeve Politike